



Pranuar / Doretuar Primiçenë/Prudato Received/Delivery	27.09.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPSHICK	5706/2022		1.15

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.707/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj - anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.707/2022 të datës 15.08.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Gjykata Supreme e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.707/2022 e datës 15.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.26/2022 i datës 22.07.2022, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**Arsyetim**

Ankuesi është i punësuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas Akt emërimit të fundit me numër 32/2018 të datës 29.01.2018, në pozitën "Zyrtar për arkiv-1", në Zyrën e Administratorit.

Me datën 29.03.2022, Administratorja e Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes shkresës zyrtare me numër 68/2022, ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që ankuesit ti ngritët paga nga koeficienti 6 në 7, pasi i njëjti i ka të përfunduara studimet në programin juridik të kolegjit AAB me datën 02.12.2016. Ndërsa me datën 17.05.2022 Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin DS-596/2022 sipas



të cilit e ka refuzuar kërkesën e ankuesit e ushtruar nga Administratorja e kësaj gjykate lidhur me ngritjen e koeficientit, me arsyetimin se plani i përgjithshëm i personelit ku është përfshirë edhe plani i punësimit në Gjykatën Supreme në të cilin planifikim me organogram pozita zyrtar për arkiv 1 është e paraparë me koeficient 6.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 23.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër 01/1289 tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimet ankimore për ngritjen e koeficientit nga 6 në 7 sipas arsyetimit se të gjitha gjykatat themelore në Kosovës kanë pozitën e zyrtarit të lartë të arhivës ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës nuk e parasheh këtë pozitë por vetëm zyrtarin e arkivës.

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 22.07.2022 ka nxjerrë Vendimin KA.nr.26/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, me arsyetimin se pozita e arkivistit të lartë nuk është e paraparë me organogramin e Gjykatës Supreme të Kosovës bazuar në Vendimin KGJK Nr.94/2022 të datës 24.02.2022 me të cilin është miratuar plani i personelit, si dhe kërkesa për ngritje të koeficientit e parashtruar nga ankuesi është refuzuar nga ana e Drejtorit të SKGJK-së.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin KA.nr.26/2022 të datës 22.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJ, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4704/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me ngritjen e koeficientit nga 6 në 7 për shkak se SKGJK-ja me një vendim edhe pozitën e sekretareve juridike i ka ngritur në pozitën si zyrtare ligjore pa procedurë të rekrutimit dhe se i njëjti kërkon që nga pozita e arkivistit me koeficient 6 të ngritet-avansohet në pozitën si zyrtar i lartë i arkivës me koeficient 7.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.08.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Gjykata Supreme e Kosovës, ndërsa me datën 23.08.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Gjykata Supreme e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4704/2022 të datës 15.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën zyrtare me numër 134/2021 të datës 31.05.2021 nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2022 së bashku me përshkrimin dhe arsyetimin e nevojave të veçanta dhe kërkesave buxhetore-2022; Rekomandimin për ngritjen e koeficientit të ankuesit nga Administratorja e Gjykatës Supreme me numër 69/2022 të datës 29.03.2022; Kërkesën për avancim të ankuesit me numër 72/2020 të datës 05.03.2020; Ankesën e ankuesit me numër 01/1289 të datës 23.06.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së; Vendimin KA.nr.26/2022 të datës 01/1451 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së; Akt emërimit të ankuesit me numër 32/2018 të datës 29.01.2018; Diplomën e ankuesit me numër NO.1624/2016 të datës



02.12.2016 nga Kolegji AAB; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.08.2022 nga Gjykata Supreme e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga KPMSHCK me numër 1731/2022 të datës 19.08.2022 sipas Gjykatës Supreme të Kosovës; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të ankuesit me numër 279/2017 të datës 25.09.2017; Fletë dërgesën me numër GJK-72/2020 të datës 05.03.2020; Kërkesën për avancim të ankuesit me numër 72/2020 të datës 05.03.2020, Shkresën zyrtare të datës 23.09.2022 lidhur me provat shtese nga Gjykata Supreme e Kosovës; Rregulloren 05/2021 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Supreme të datës 31.12.2021; Organogramin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar legjislacionit për shërbimin civil respektivisht nenit 18 paragrafit 3 dhe paragrafit 5 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: *“3. Pranimi në shërbimin civil në pozicionet e karrierës është i hapur për të gjithë kandidatet për të gjitha pozicionet jo drejtuese në çdo institucion. Për pozicionet drejtuese dhe pozicionet e larta drejtuese, pranimi kryhet nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë ekzistues. Në rast se nuk ka kandidatura nga nëpunësit civilë ekzistues, apo kandidatët kanë rezultuar të pa përshtatshëm në përfundim të procesit të konkurrimit, pranimi hapet për të gjithë të interesuarit. 5. Për pozita menaxheriale, pranimi bëhet me anë të avancimit të nëpunësve ekzistues civilë”,* si dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil përcakton se: *“1. Shpallja për avancim bëhet nga njëria e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë. 2. Shpallja e avancimit fillimisht bëhet brenda njësisë së institucionit. 3. Nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje, njëria e personelit shpall konkurs në nivel institucioni. 4. Shpallja duhet të jetë e hapur së paku 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit”,*konstaton se ngritja e koeficientëve dhe gradave duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjit si dhe dispozitat ligjore lidhur me avancimet të përcaktuara me nenin 27 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“1. Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të:.....1.4 kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale”.*Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi bazën e parimit të barazisë dhe jo-diskriminimit ose kriterëve të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, e pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji lidhur me rastin e ankuesit ka vlerësuar se meqenëse nuk kemi dëshmi se i njëjti i është nënshtruar procedurave lidhur me ngritjen në detyrë, nga pozita si “Zyrtar i arkivës 1” në pozitën e pretenduar “Zyrtar i lartë i arkivës” në Gjykatën Supreme të Kosovës, i njëjti ngritjen në detyrë apo marrjen e një



pozite më të lartë në këtë institucion, nuk mund ta realizoj në asnjë formë tjetër dhe në këtë kuptim edhe pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me ngritjen e koeficientit nga 6 në 7 është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar Rregulloren 05/2021 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të datës 31.12.2021 në Gjykatën Supreme të Kosovës, ka konstatuar se në nenin 13 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të kësaj rregulloreje parashihet vetëm pozita "Arkivist" dhe hyn në kuadër të Zyrës për menaxhimin e lëndëve e ku si shtojcë e kësaj rregulloreje është i bashkangjitur edhe organogrami i kësaj gjykate me q' rast i njëjti parashihet pozitën vetëm të arkivistit në kuadër të po kësaj zyre e jo edhe të zyrtarit të lartë të arkivës siç pretendon ankuesi. Andaj bazuar në faktet dhe provat e argumentuara si me lartë, Kolegji ka konstatuar se meqë pozita e zyrtarit të lartë të arkivës nuk është e parashikuar me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Kosovës, i njëjti nuk mund të pretendoj një pozitë e cila nuk ekziston në këtë institucion.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore, rregullat si dhe parimet e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që procedurat e avancimit në shërbimin civil bëhen në pajtim me nenin 27 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe me dispozitat e nenit 10 të Rregullosës Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil dhe mbi këtë bazë Gjykata Supreme e Kosovës, për ngritjen e koeficientit të nëpunësve civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7), duhet të zhvillojë procedurë të rekrutimit në pajtim me dispozitat e lartë cekura në bazë të planit të Njësisë së Burimeve Njerëzore, për pozitën e lira në këtë institucion.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.26/2022 të datës 22.07.2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.707/2022, datë 27/09/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Shkelzen Maliqi, Drejtor i SKGJK-së;

Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe

Arkivit të KPMSHCK-së.

